# DËSHMI ARKIVI

**A-465113**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nations League ndizet që në start: Xavi e Klopp sfidohen në Holandë-Gjermani, debuton Kosova e "trazuar" e Fodas |
| ADRESA | `https://lapsi.al/nations-league-ndizet-qe-ne-start-xavi-e-klopp-sfidohen-ne-holande-gjermani-debuton-kosova-e-trazuar-e-fodas-i1094368` |
| BURIMI | lapsi.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 08:50:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 08:43:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `73f799457a019cd84e962b97a9e72965f13bc6825e442a7d76ba6bba97283c80` |
| TEKSTI | `c41bf9721d352d75bd78cd8e0247567fff984e080570f3d9c687c38534fd6c25` |
| PAMJA | `d4816223fd95b39f6cbf7148ce6669403d3e86b741b02ed8434e9cdfa32258fd` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0350a731266e4261e4325764fc1d8553e5906fd86ecf401756bd6822a74ed0d2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9a6b20a4f7bca7d38b85ed38d229f05609a1ca606edde02ba3c9e62d673a221c` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0350a731266e4261e4325764fc1d8553e5906fd86ecf401756bd6822a74ed0d2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Nations League ndizet që në start: Xavi e Klopp sfidohen në Holandë-Gjermani, debuton Kosova e "trazuar" e Fodas

Xavi dhe Klopp përballen që në debutim në një klasik të futbollit europian, ndërsa Kosova pret Irlandën në "Fadil Vokrri". Portugalia, Danimarka dhe Norvegjia janë gjithashtu në fushë në një mbrëmje të ngjeshur të Ligës së Kombeve.

LAPSI.AL • 24 SEPTEMBER 2026



Liga e Kombeve rikthehet këtë të enjte me një mbrëmje të pasur me sfida, ku vëmendjen kryesore e merr përballja mes Holandës dhe Gjermanisë, por në qendër të interesit shqiptar është edhe dueli Kosovë-Irlandë.

Tetë ndeshje janë programuar për mbrëmjen e sotme, me pjesën më të madhe që startojnë në orën 20:45. Përballja në Amsterdam ka një veçanti të rëndësishme: dy trajnerët e rinj, Xavi Hernández dhe Jürgen Klopp, do të debutojnë në stolin e përfaqësueseve të tyre pikërisht në një përballje të madhe europiane.

### Xavi kundër Kloppit, një debutim që nis me "klasiken"

"Johan Cruyff Arena" do të jetë skena e një prej ndeshjeve më interesante të kësaj mbrëmjeje. Holanda nis një kapitull të ri me Xavi Hernandez, ndërsa Gjermania i ka besuar stolin Jürgen Klopp. Për spanjollin bëhet fjalë për rikthimin në futbollin ndërkombëtar në një rol të ri, këtë herë si trajner i Holandës. Ish-trajneri i Barcelonës dhe ish-mesfushori i Spanjës ka deklaruar se kërkon një skuadër me intensitet të lartë, iniciativë dhe një identitet të qartë në lojë.

Në krahun tjetër, Klopp nis aventurën me Gjermaninë pas emërimit në muajin korrik. Ish-trajneri i Liverpoolit dhe Borussia Dortmundit e nis detyrën me një transfertë të vështirë dhe me një kundërshtar historik. Pikërisht për këtë arsye, Holandë-Gjermani nuk është thjesht një ndeshje e parë e Nations League. Është edhe prova e parë e dy ideve të reja, me dy trajnerë me filozofi dhe eksperienca të ndryshme që kërkojnë të ndërtojnë ekipet e tyre. Edhe vetë Klopp ka zgjedhur ta nisë me humor përballjen me Xavin, duke bërë shaka për njohuritë e tij mbi futbollistët holandezë.

### Kosova pret Irlandën, nis misioni në Ligën B

ide


Rënia e Vlorës në shtratin e krimit
Armand Shkullaku


Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi
Andi Bushati

MOTI TIRANA 22°C
KËMBIMI EURO 91.46

aktuale

07:44
Ditë e ngarkuar në Kuvend: Protestë jashtë, interpelanca dhe debate brenda

20:33

Protestuesit kërkojnë "kokën" e Ramës: Krejt ekipi në pranga, s'të shpëton dot as banda

PROMO


TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në

Me interes nga publiku

### Kosova pret Irlandën, nis misionin në Ligën B

Në Prishtinë, Kosova përballet me Irlandën në një sfidë që merr një rëndësi të veçantë për nisjen e fushatës në Ligën B, Grupi 3. "Fadil Vokrri" pritet të jetë i mbushur, me ndeshjen që starton në orën 20:45. Federata Irlandeze konfirmon se kjo është përballja e parë konkurruese mes Kosovës dhe Irlandës.

Irlanda vjen në Prishtinë pas katër ndeshjeve konkurruese pa humbje dhe kërkon ta vazhdojë këtë seri edhe në startin e Nations League. Në krahun tjetër, Kosova synon ta shfrytëzojë faktorin fushë për të marrë pikët e para në një grup ku bëjnë pjesë gjithashtu Austria dhe Izraeli.

Përballja në Prishtinë ka edhe një element interesant në stol: trajneri irlandez Heimir Hallgrímsson e ka pranuar se vëmendja para ndeshjes është zhvendosur pjesërisht edhe te deklaratat e tij të ditëve të fundit, duke theksuar se fokusi duhet të rikthehet te sfida me Kosovën.

### Portugalia nis mbrojtjen e titullit

Në Ligën A, Portugalia pret Uellsin, në një tjetër prej sfidave të mbrëmjes.

Portugezët hyjnë në këtë edicion me statusin e kampionëve në fuqi të Nations League dhe kërkojnë një start pozitiv. Përballë do të jetë Uellsi, në një ndeshje që mund të vendosë menjëherë ritmin në Grupin A4. Në të njëjtin grup, Norvegjia pret Danimarkën, duke kompletuar një mbrëmje të fortë nordike.

### Serbia-Greqi, përballja tjetër e Grupit A2

Në Grupin A2, krahas Holandë-Gjermani, luhet edhe Serbi-Greqi. Kjo do të jetë një tjetër përballje me peshë në një grup ku Holanda dhe Gjermania pritet të tërheqin pjesën më të madhe të vëmendjes. Dy skuadrat e tjera do të kërkojnë ta nisin me rezultat pozitiv për të mos humbur terren që në javën e parë.

### Austria dhe Izraeli, përballje tjetër në grupin e Kosovës

Në Grupin B3, në të cilin bën pjesë edhe Kosova, luhet gjithashtu Austri-Izrael. Kështu, pas përfundimit të dy ndeshjeve të para të grupit, do të kemi një panoramë të parë të renditjes dhe të objektivave të katër skuadrave.

### Dy ndeshje në Ligën D

Mbrëmja kompletohet me dy sfida të Ligës D. Në orën 18:00, Andorra përballet me Maltën, ndërsa në 20:45 luhet Lihtenshtajn-Lituani.

### NDESHJET E MBRËMJES NË UEFA NATIONS LEAGUE

League A: Group 2

20:45 Netherlands - Germany

20:45 Serbia - Greece

League A: Group 4

20:45 Norway - Denmark

20:45 Portugal - Wales



**Përgjimet ekskluzive/ "O shpirt", "o zemër". Vlora, një spiune që pasioni e çoi drejt krimit**



Bomba tjetër për qeverinë Rama/ Prova e fakte se ku shkojnë paratë e zhvatura nga korrupsioni



Mesazhet me shefen e SHISH/ Gys Agasi i mbajti shpresat te Edi Rama deri në fund



Zbulohet kush e zëvendëson Vlora Hysenin në krye të SHISH

League B: Group 3

20:45 Austria - Israel

20:45 Kosovo - Ireland

League D: Group 1

18:00 Andorra - Malta

League D: Group 2

20:45 Liechtenstein - Lithuania

Në një mbrëmje ku Nations League hap siparin e edicionit të ri, Holandë-Gjermani është padyshim ndeshja që mbledh më shumë vëmendje, jo vetëm për historinë e përballjes, por edhe sepse Xavi dhe Klopp do të bëjnë debutimin e tyre zyrtar në pankinat përkatëse. Në Prishtinë, ndërkohë, fokusi do të jetë te Kosova, që kërkon ta nisë me këmbën e mbarë aventurën në Ligën B.


## Të këshilluara



**Portieri kthen shpinën gjatë penalltisë absurde: kishte marrëveshje me sulmuesin, por tradhtohet**

Një portier që, në vend që të përqendrohet plotësisht për të provuar të presë një penallti ose të përpiqet në maksimum të destabilizojë kundërshtarin, kthen shpinën ndaj ekzekutuesit.



**Aksidenti absurd, 20-vjeçari Oskar Kordus humb jetën: një kaproll i futet përmes xhamit të përparmë të makinës**

Futbolli polak po vajton këto orë Oskar Kordus, futbollistin 20-vjeçar që të hënën humbi jetën në rrethana sa të pafata, aq edhe absurde.



**Klopp i ndalon lojtarëve të Gjermanisë parukierin: rregulla strikte për kombëtaren e tij**




### Përplasje verbale mes Van Dijk dhe një gazetari në sallën e konferencës: “Keni përhapur marrëzira”

Kapiteni Virgil Van Dijk u përfshi në një debat me Noa Vahle dhe më pas me Maarten Wijffels, Martijn Krabbendam dhe Valentijn Driessen gjatë konferencës për shtyp në prag të ndeshjes.



### "Jam futbollisti më i bukur në botë": moda, aludimet dhe raporti i Maduka Okoye me Belen

Maduka Okoye ishte një prej shumë sportistëve protagonistë të Milano Fashion Week. Portieri i Udineses mori pjesë në aktivitetet e javës së modës



### Sulmi kuqezi kundër teknikut Sylvinho, Daku e Seferi kunja brazilianit: "Tani e ndjejmë rëndësinë"

Në konferencën për shtyp, dy sulmuesit kuqezi Daku e Seferi, kanë shënjestruar brazilianin Sylvinho mes rreshtave, duke i thurur elozhe teknikut të ri Rolando Maran.



## Kush është Younes Ebnoutalib, i thirrur nga Klopp te Gjermania me një përvojë te Perugia në Serie C: “Më trajtuan si qen”




### Serie A, parashikimet e Superkompjuterit: Interi kampion, Milan dhe Napoli jashtë Champions

Në pritje për të përjetuar sërish emocionet e Serie A, provojmë të imagjinojmë kampionatin që do të jetë falë Superkompjuterit.



### E bujshme te Napoli: “Allegri drejt dorëheqjes!”. Ja si qendron situata

Paraqitjet e fundit të Napolit kanë shtuar diskutimet për të ardhmen e teknikut Massimiliano Allegri, por në këtë moment nuk do të kishte bazë për të imagjinuar një largim të parakohshëm.



### Belen Rodriguez, natë feste në Milano me portierin e Udineses: lajmi bëhet viral

Me rastin e festimeve për ditëlindjen e saj të 42-të, të organizuara në lokalin argjentinas “El Porteño Prohibido”, mes të ftuarve të showgirl-it nga Amerika e Jugut u shfaq edhe Maduka Okoye, portieri i Udineses.




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.